



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 699/prot.

Fier, më 16.06.2021

Lënda: Njoftim për aplikimin në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021

Në zbatim të shkresës së MASR-së nr. 3375 prot., datë 14.6.2021, për realizimin e procedurave të konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2021, njoftohen për sa vijon të gjithë kandidatët e interesuar për t’u punësuar në institucionet arsimore publike në juridiksionin e DRAP Fier (bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Lushnjë, Divjakë, Mallakastër, Vlorë, Himarë, Selenicë, Tepelenë, Memaliaj, Gjirokastër, Libohovë, Përmet, Këlcyrë, Finiq, Dropull, Sarandë, Delvinë, Konispol):

1. Baza ligjore mbi të cilën do të procedohet për konkurrimin nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë” 2021 do të jetë udhëzimi i MASR-së nr. 12, datë 10.6.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””.
2. Të gjithë kandidatët e interesuar (përfshirë edhe kandidatët që kanë marrë pjesë në portalin e fundit dhe që dëshirojnë të konkurrojnë përsëri) duhet që, deri në datën 25 qershor 2021:
 - a) të regjistrohen online në portalin “Mësues për Shqipërinë”, duke ngarkuar në platformën e aplikimit dokumentet për konkurrim;
 - b) të dërgojnë dosjen me dokumentet për konkurrim nëpërmjet shërbimit postar në adresën: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, Lagjja “Kastriot”, rruga “Leon Rei”, Fier; **me përjashtim të kandidatëve të profilit të arsimit parashkollor**, të cilët e dërgojnë dosjen nëpërmjet shërbimit postar në adresën e zyrës vendore të arsimit parauniversitar ku kanë vendbanimin. **Për arsye të ndryshimit të mënyrës së vlerësimit sipas udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, edhe kandidatët që kanë marrë pjesë në portalin e fundit duhet të dorëzojnë dosjen me të gjitha dokumentet e kërkuara.** Dosja duhet të përmbajë dokumentet e kërkuara dhe të renditura sipas shtojcës 1 të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, të shoqëruara me një fletë prezantuese të firmosur nga kandidati. Krahas kopjeve të dokumenteve të ngarkuara online, në dosje kandidati duhet të paraqesë edhe dokumentet që vërtetojnë vitet e punës sipas pikës 5 të shtojcës 2 të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021 (librezën e punës dhe/ose vërtetim të vjetërsisë në arsim), nëse dëshiron t’i llogaritet përvoja në punë në mësimdhënie dhe/ose në drejtimin e IA-ve. Dokumentet e fotokopjuara që dorëzohen në dosje të jenë detyrimisht të njësuara me origjinalin (të noterizuara).

- c) Kandidatët dorëzojnë në DRAP ku kanë qendrën e banimit një kopje të kërkesës për konkurrim (sipas shtojcës 4 të udhëzimit nr. 12, datë 14.6.2021) dhe të dokumentacionit të ngarkuar online. Shtojca 4 shkarkohet dhe printohet pas aplikimit online në portalin **mesuespershqiperine.al**.
3. Çdo ZVAP, pas vlerësimit nga KVD-ja e ngritur në të në përputhje me pikën 3 të kreut 5 të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, dërgon deri në datën 3 korrik 2021 me shkresë zyrtare dhe në rrugë elektronike në DRAP Fier tabelën e vlerësimit të dosjeve të aplikantëve të arsimit parashkollor.
4. Kandidatët do të njoftohen nga DRAP Fier në datën 4 korrik 2021 nëpërmjet shpalljes në faqen zyrtare në internet: **fier.arsimiparauniversitar.gov.al**. Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë për vlerësimin e marrë brenda datës 10 korrik 2021. Shqyrtimi i ankesave dhe shpallja e rezultateve përfundimtare të vlerësimit të dosjeve bëhet deri në datën 15 korrik 2021.

DREJTORI



BRUNILDA DHAMO